

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rimbushje fikse zjarri

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24951230-6 - Mbushje për bombola gazi zjarrfikës,

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,013,092 (një milion e trembëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari i ofertës dhe çmimit, sipas shtojcës 1 dhe 2.
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit e konkretisht **405,237** (katërqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 55, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar. Nëpërmjet kësaj kërkesë vërtetohet besueshmëria dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Duke qenë një kontratë e rëndësishme për shërbim specifik për ruajtjen e personelit dhe studentëve nëpërmjet sigurimit të pronës, pajisjeve, etj, kërkohe vlera maksimale e lejuar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **202,618** (Dyqind e dymijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme mbi sigurimin e pronës, pajisjeve, etj., mbështetur në vlerat kontabës dhe termat e referencës. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë shërbimin, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 “Per menaxhimin e cilësisë” objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, e vlefshme .

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizajnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete pjese te stafit 1(nje) punonjes te paisur me Certificate per ushtrimin e profesionit “Ekspert Zjarrfikës” lëshuar nga PMNZSH, Ministria e Brendshme. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, certifikatën, listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Punonjesi i paisur me Certificate per ushtrimin e profesionit “Ekspert Zjarrfikës” është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e këtij punonjesi që do të mbikqyrin realizimin e këtij shërbimi.

Kriteri i mesipërme është vendosur në përputhje me ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeda teknike për lëndët shuarëse dhe Autorizim prodhuesi/distributori për përdorimin e tyre i vlefshëm për vitin 2024.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për shërbimet/mallrat e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 (një) auto laborator profesional të tipit kombinat i cili të mundëson kryerjen e të gjithë shërbimit të kërkuar në vend sipas procesit të mëposhtëm në prani të specialistëve të ngarkuar nga A.K:

- a) Provën e presionit hidraulik të fikseve të zjarrit si dhe provën e presionit të tubave zjarrfikës për përdorim në hidrante dhe automjete zjarr fikse.
- b) Rimbushjen dhe kolaudimin sipas llojit të lëndëve shuarëse: pluhur, shkumë, CO2.

Për laboratorin, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeden teknike si dhe katalogun perkates ku specifikohen qartesisht proceset e punes per te cilat eshte prodhuar.

- Kur mjeti është në pronesi, duhet të paraqitet:
 - a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - b) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
 - c) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

- Kur mjeti nuk është në pronësi të ofertuesit duhet të paraqitet:
 - a) kontrata e qerase/huapërdorjes, etj;
 - b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
 - ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.6 Për rritjen e sigurisë dhe lehtësisë në mënyrën e përdorimit, çdo aparati të fikjes së zjarrit duhet t’i vendoset një qafore plastike për çdo vit, me ngjyrë të veçantë nga viti në vit, ndërmjet qafës së cilindrit (bombulës) dhe aparatit (fiksës) ku të ketë të stampuar kohën e mirëmbajtjes/ rimbushjes (data/muaji/viti). (Deklarate nga ofertuesi)

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

